



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË

NOTER ETLEVA B. STAMO  
ADRESA 29 NENTORI, DERVISH  
HEKALI  
TEL:

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 980

Nr. koleksioni: 457

Fier më 20/04/2022

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2022062230047799389



A.202206223004799389

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**  
(TË SHOQËRISË "OZGURKAN ALBANIA " SH.P.K)

Ne Fier, sot, më datë 20.04.2022, para meje Notere ETVLEVA B. STAMO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLOREË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERSH HEKALI, u paraqit personalisht:

**SHITES:** Hadi Ozgurkan, atësia Taner, amësia Sibel, shtetas Turk, lindur në Kadikoy dhe banues në Turqi, me adresë Turqi, lindur më 02/12/1989, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaportë e shtetit Turk nr. U22193639 dhe nr. personal 17821523144, këtu në cilësinë e ortakut të Shoqërisë "Ozgurkan Albania" shpk, person juridik shqiptar, identifikuar me NUIS L83217402S, me zyrë qendrore të Shoqërisë në Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga "Leonardo Murialdo", banesa nr. 61, zk. 3981, numër pasurie 186/61, Fier, mbajtës i 1(një) kuote, që përfaqëson 40% të Kapitalit të Shoqërisë. (në këtë kontratë do të quhet "Shitësi")

Pala shitese nuk e njeh gjuhën shqipe, por komunikon në Turqisht dhe në Anglisht dhe une Noterja në mbështetje të nenit 100 të ligjit nr. 110/2018, kryesisht caktoj përkthyesin zyrtar të Gjuhës Angleze z. Edmond Fejzulla me numër personal H70417096P, i cili pranohet nga palët dhe deklaron se do ta përkthejë përmbajtjen e aktit fjalë për fjalë.

**BLERES:** Erjon Tahiraj, atësia Yzeir, amësia Servete, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë L. Sheq i Madh Rruga Teodor Muzaka Njesia Nr.2 Fier; Nd. 57; Fier; Fier; 9305; Fier, lindur më 01/09/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034035876 dhe nr. personal I30901055D.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakort dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kapitalit të Shoqërisë "Ozgurkan Albania" Shpk, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**MEQENESE:**

- Pala Shitëse është ortak i shoqërisë "Ozgurkan Albania" shpk, Subjekt juridik Shqiptar identifikuar me NUIS L83217402S, me zyrë qendrore të Shoqërisë në Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga "Leonardo Murialdo", banesa nr. 61, zk. 3981, numër pasurie 186/61, Fier, kapital themeltar 1.000,00 Euro, me pjesmarrje 40% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë me vlerë 400,00 (katërqindë) Euro, zotërues i 1(një) kuote, që përfaqëson 40% të Kapitalit të Shoqërisë.

Pala shitese Hadi Ozgurkan nga kuotat e kapitalit që zoteron dhe i ka në pronësi të tij në Shoqëri, 10% të tyre e transferon tek Blerësi nëpërmjetë shitblerjes, miratuar me Vendimin e Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë "Ozgurkan Albania" shpk.

- Palët kanë rënë dakort që Ortaku Hadi Ozgurkan të shes ortakut Erjon Tahiraj 10% të kapitalit të shoqërisë që ka në pronësi.

ATËHERË, meqënëse egzistojnë parashtrimet si më sipër, palët bien dakord dhe lidhin këtë kontratë me kushtet si më poshtë:

**Neni 1.**

Parashtrimet

1.1. Parashtrimet e përcaktuara më sipër janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.



A2021062230047799389

**Neni 2**

Objekti i Kontratës

2.1. Objekt i kësaj kontratë është shitja e 10% të Kapitalit të Shoqërisë që Shitësi zotëron në para ( Euro ) në shoqërinë "Ozgurkan Albania " shpk .  
Transferimi i pronësisë të Kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kësaj shitblerje do të kryhet nga Shitësi tek Blerësi, duke kaluar pronësinë e bleresit 10% të Kapitalit të Shoqërisë që ai zotëron në shoqërinë "Ozgurkan Albania " shpk.

**Neni 3.**

Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës

3.1 Çmimi i shitjes së 10% te kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet te kaloj ne favor te Shitësit për blerjen e tyre është në vlerën e shprehur ne Euro100,00 (njëqind).

3.2 Palët deklarojnë se Blerësi do të likujdojë vlerën prej 100,00 (njëqind) Euro, duke e derdhur në llogarinë bankare të Shitësit, e cila përbën vlerën e ¼ pjesë të kuotës së shitësit, për të cilën palët jane dakordesuar.

**Neni 4.**

Pronësia e kuotave

4.1 Palët bien dakord që pronësia mbi ¼ e kuotës që zotëron shitësi kalon në favor të palës blerëse pasi pala blerëse të derdh vleren monetare te blerjes dhe rregjistrimin e kontratës në Qendrën Kombëtare të Biznesit duke u bërë kështu pala blerëse bashkëpronare e ¼ pjesë të kuotës që përfaqëson 40% të Kapitalit të Shoqërisë që bleu dhe njëkohësisht ortak i shoqërisë "Ozgurkan Albania" shpk , dhe zotërues i ¼ pjesë në bashkëpronësi të kuotës që përfaqëson 40% të Kapitalit të Shoqërisë "Ozgurkan Albania " shpk me vlerë 100,00( njëqind ) Euro dhe pala shitese Hadi Ozgurkan mbetet ortak i Shoqërisë "Ozgurkan Albania" shpk , zotërues i 3/4 pjesë në bashkëpronësi të kuotës që përfaqëson 40% të Kapitalit të Shoqërisë "Ozgurkan Albania " shpk me vlerë 300,00( treqind ) Euro .

4.2 Palët deklarojnë dhe bien dakort se kuota është e lirë nga çdo pretendim i të tretëve, nuk është e rënduar me barrë apo të ketë proces gjyqësor në lidhje me pronësinë , konfirmuar dhe nga rezultati i kërkimit në RBS.

**Neni 5.**

Rregjistrimi në QKB

5.1 Blerësi pasi të derdhi në llogarinë e palës shitëse të gjithë shumën e blerjes të një nga katër pjese te kuotës, duhet të depozitojë këtë kontratë në QKB, duke shlyer detyrimet e rregjistrimit.

**Neni 6.**

Shpenzimet për përpilimin e dokumentacionit

6.1 Në mbështetje të nenit 708 të Kodit Civil "Shpenzimet e kontratës së shitjes dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të janë në ngarkim të blerësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe".

**Neni 7.**

Baza Ligjore

7.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

7.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

7.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**Neni 8 .**

Të ndryshme

8.1. Kjo kontratë lidhet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të kundërt, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier .

**Neni 9.**

Hyrja në Fuqi e Kontratës

9.1 Kjo kontrat hyn në fuqi menjëhere me nënshkrimin e saj.

**Neni 10**

Anekset e Kontratës



A2022062230047799389

10.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme i Shoqërisë " Ozgurkan Albania " shpk
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "Ozgurkan Albania " Shpk.
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Faturë e transfertës bankare
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

**Neni 11.**

Dispozitat Përfundimtare

11.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja dhe perkthyesi zyrtar Edmond Fejzulla me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese , të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

11.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

11.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALET KONTRAKTUESE**

SHITES

Hadi Ozgurkan


*Hadi Ozgurkan*

*Him*

BLERES

Erjon Tahiraj

*Erjon Tahiraj*



PERKTHYESI ZYRTAR

Edmond Fejzulla



NOTERE  
ETLEVA B. STAMO

*Edleva B. Stamo*

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20220420105130586  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 20.04.2022  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 10:51:30AM  
Lloji i Kerkimit: D-400-116-5180  
Numri i Dokumentit:  
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

OZGURKAN ALBANIA SH.P.K.



*Handwritten signature: Hoxha Arusha*